



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 328/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Janez Frrokaj, në cilësinë anëtarit të këtij subjekti politik, për shkak të bërges së fushatës zgjedhore për subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, ndërsa subjekti politik PSHDK është në koalicion me Partin Demokratike të Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur me 08.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REUZOHET** ankesa si e pabazuar.

## A R S Y E T I M

Subjekti politik PSHDK, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se Janez Frrokaj, në cilësinë anëtarit të këtij subjekti politik, sepse kandidati i lartë cekur sipas parashtruesit të ankesës është duke bërë fushatë me akronimin të PSHDK-së për subjektin politik AAK, ndërsa subjekti politik PSHDK është në koalicion me subjektin politik PDK. Në ankesë theksohet se në bazë të nenit 5 të statusit të subjektit politik PSHDK-së vetëm kryetarit të partisë i lejohet të bëjë marrëveshje me subjektit politike.

Më 06 Dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PSHDK, me pretendim se anëtar i këtij subjekti politik Janez Frrokaj është duke bërë fushatë zgjedhore pa lejen e kryesisë së këtij subjekti politik. Sipas parashtruesit të ankesës kjo është në kundërshtim me nenin 5 të statusit të këtij subjekti politik sepse të drejtën për të bërë marrëveshjet politike me subjekte tjera e ka vetëm kryesia e këtij subjekti politik. Parashtruesi i ankesës ka propozuar që të merren masat e parapara ligjore.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përbushin standarde*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, nen 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtit nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, gjeti se ankesa është e pabazuar ngase parashtuesi i ankesës nuk ka ofruar dëshmi të asaj natyre që do të ndikonin në marrjen e vendimit. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZPsë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa**

A nr. 328/2010 më datën 08.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muhamed Rexha**

